




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 39 paragrafi 1.4, në nenin 49 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.03.2012 miratoi këtë

VENDIM

Bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2011, në vitin fiskal 2012

I

Me këtë vendim lejohet bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2011, në vitin fiskal 2012.

II

Mjetet e pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2011 në shumë prej 110.221,77€ barten në:

Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej 4.429,58€ Mallra dhe Shërbime,
Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej 1.657,85€ Shpenzime komunale,
Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej 297,15€ Subvencione dhe Transfere.
Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej 82.631,19€ Shpenzime Kapitale dhe atë në "Projektet e papërfunduara nga viti paraprak".
Programi 920 Arsim dhe shkencë (nënprogrami 92135 Administrata e Arsimit) në shumë prej 21.206,00€ Paga dhe mëditje.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Kryetari i Komunës, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16-23641
Gjilan, më 02.03.2012

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues